

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
622-23-10114-5-2-1/C1346

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

GOE . Limit L&B SH.P.K.; REHA EPOXID SH.P.K., Xheladin Hana nr.20, PRIZREN, (në vazhdim "Kontraktori"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për Punët e riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

Mirëmbajtja e komplekseve memoriale në komunën e Prizrenit me numër identifikues: 622-23-10114-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim:

Mirëmbajtja e komplekseve memoriale në komunën e Prizrenit

| <i>Nr.</i> | <i>Grupi</i> |
|------------|---|
| 1 | Mirëmbajtja e komplekseve memoriale në komunën e Prizrenit |

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative . Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorjné punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 01. 03. 2024 dhe përfundon me 28. 02. 2026

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë **3** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë **[Territori i Komunës së Prizrenit]**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është **297.62 € (dyqind e3 nëntëdhjetë e shtat euro e gjashtëdhjetë e dy cent është çmimi i peshuar me të cilin është bërë vlerësimi i ofertave ndërsa**

Kontrata do të lidhet dhe do të realizohet sipas çmimeve për njësi të ofruara nga OE dhe totali i këtyre çmimeve për njësi është 1,174.60 € (një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent) çmim për njësi

Vlera e parashikuar e kontratës për 24 muaj është 200,000.00 | (dyqind mijë euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët []¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.


¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues

| | |
|-------------|---|
| Emri: | Isa Osmankaj |
| Pozita: | Zyrtar përgjegjës i prokurimit |
| Nënshkrimi: |  |
| Data: | 28.02.2024 |
| Vula: | |



Për Kontraktorin

| | |
|-------------|---|
| Emri: | Liman Asllani |
| Pozita: | Menaxher |
| Nënshkrimi: |  |
| Data: | 28.02.2024 |
| Vula: | |



KUSHTET E VEÇANTA
622-23-10114-5-2-1/C1346

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulojnë nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe . |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 25 muaj kalendarik . |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të |

| | | |
|--|------|--|
| | | projektit. |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 24 muaj kalendarik |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Një regjistër i punës do të mbahen në vendpunishte nga ana e Kontraktuesit, |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Adem Morina Drejtor në DKRS Menaxheri i Kontratës është: Sazan Cukaj zyrtar në DKRS |
| Parapagimi | | Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake |
| Mbajtja e Parasë | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës. |
| Shkaqet për kompensim | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve. |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | 43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi. |

KOMUNA E PRIZRENTIT

PARAMASA DHE PARALLOGARIA:

PROJEKTE: Mirëmbajtja e Komplekseve Memoriale në territorin e Komunës së Prizrenit



| Nr | Përshkrimi | Njesia | Sasia | Çmimi | Vlera |
|----|--|--------|-------|-------|------------------------|
| A | AKCESOR | | | | Çmimi i peshuar = 40 % |
| 1 | Sanimi i shtyllës, ngjyrosja, vendosja e kanapit për ngritje e ulje të Flamurit dhe mekanizmit të nevojshëm. | copë | 1 | 4.00 | 1.60 |
| 2 | Furnizimi, transportimi dhe vendosja e shtyllës së flamurit me lartësi deri në h=12 m'. Në çmim të përfshihet punimi I bazës së betonit me të gjitha punët paraprake, ankerimi I shtyllës në bazë të betonit, si dhe mekanizmat përcjellëse për flamur. | copë | 1 | 38.00 | 15.20 |
| 3 | Furnizimi dhe vendosja e Flamurit të R. Kosovës dhe atij Kombëtar me dimension 1x1.5 m | copë | 1 | 1.00 | 0.40 |
| 4 | Sanimi dhe riparimi i ulseve ose zevendesimi i tyre me të reja, ulset janë me mbajtëse nga betoni i armuar dhe ulse druri. Konstruksioni mbajtëse duhet të mbrohet me ngjyre betoni kurse ulset e drurit me ngjyre mbrojtëse për dru. Dimenzioni i ulseve 200x70x65 cm, mbajtëset e betonit duhet të vendosen në themele ose të ankerohen në pllake betoni, varesisht nga gjendja në terren. | copë | 1 | 18.00 | 7.20 |
| 5 | Grryerja, sanimi dhe lyerja e ulseve nga druri dhe mbajtëseve nga metali (sadorin palisandar dhe emajllak mat i zi), në çmim të llogaritet edhe zevendesimi i elementeve të demtuara nga druri me elemente të reja. Me gjatësi (Lmes = 2.0 m) | copë | 1 | 4.00 | 1.60 |
| 6 | Furnizimi me gyp për sistemin e ujitjes "pike për pike" dhe shtrirja e tij në gjithë sipërfaqen e Kompleksit | m | 1 | 4.00 | 1.60 |
| 7 | Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes së gjelbrimit duke përfshirë blerjen dhe montimin e spërkatësve, ventilave, gjysëm lidhëseve, valvula, teshtikave me qelqim të funksionimit të plotë (të mirëmbahet sipas nevojës). | copë | 1 | 9.00 | 3.60 |
| 8 | Mirëmbajtja e koshave (shportave) statikë për hedhurina, zevendesimi I të vjerave me të teja, dizajni i shportave përzgjedhet nga investitori ose sipas dizajnit egzistues. | copë | 1 | 8.00 | 3.20 |

W

W

W

W

W

W

W

W

| | | | | | | |
|----------|--|------|---|---------------|--------------|---|
| 9 | Mirëmbajtja e koshave (shportave) statikë për hedhurina, riparimi i koshave egzistues. | copë | 1 | 2.00 | 0.80 | W |
| 10 | Furnizimi dhe vendosja e logos se gravuar te UÇK-se me dimenzion Ø 60 cm dhe trashesi t = 6 cm se bashku me pjesen e mbeshtetjes ne kontrukcion mbajtese per fiksion | copë | 1 | 105 | 42.00 | W |
| 11 | Pastrim i Shtatorese nga yndyrat, allgat e ndotjet tjera dhe lyerja e saj me ngjyre bronxe e rezistueshme ne ambient te jashtem dhe UV. Ne cmim parashihet edhe vendosja e skeleve. | copë | 1 | 4.00 | 1.60 | W |
| 12 | Pastrim i lapidarit dhe lyerja e saj me ngjyre metalike ne dy shtresa e rezistueshme ne ambient te jashtem, nuanca e ngjyres caktohet nga organi mbikqyres. Ne cmim parashihet edhe vendosja e skeleve | copë | 1 | 4.00 | 1.60 | W |
| 13 | Pastrimi dhe vendosja e shkronjave që mungojn kanë lartësi 3-5 cm me ngjyr dhe dizajn sikur ato egzistuese, në çmim të parashihet edhe vendosja me ngjitës rezistent. | copë | 1 | 12.00 | 4.80 | W |
| 14 | Ngjyrosja ulseve egzistuese te rumbullakta Ø 200 cm me ngjyre betoni- akril | copë | 1 | 11.00 | 4.40 | W |
| I | Gjithsejt punet e aksesorit | | | 224.00 | 89.60 | W |

| | | | | | | |
|-----------|---|----------------|---|--------------|--------------|---|
| A | OBJEKTET (Muzeu) | | | | | |
| 1 | Gërryerja dhe largimi i pjesëve të dëmtuara të suvatuara me heret në muret e brendshme të Muzeut. Në cmim të përfshihet blerja e materialit dhe suvatimi i hapësirave. | m ² | 1 | 1.00 | 0.40 | W |
| 2 | Furnizimi dhe patinimi i mureve në dy shtresa me glet masë; gërryerja me letër grithëse, lyerje paraprake me "Primer". | m ² | 1 | 3.00 | 1.20 | W |
| 3 | Furnizimi me material si dhe ngjyrosja me dy shtresa e mureve, plafoneve me ngjyrë të kualitetit të lartë sipas kërkeses se investitorit. | m ² | 1 | 1.10 | 0.44 | W |
| 4 | Sanimi i betonit dhe lyerja me ngjyre betoni e mureve dhe sipërfaqeve te nevojshme | m ² | 1 | 2.00 | 0.80 | W |
| 5 | Furnizim me preparate adekuate për pastrimin e xhamave dhe fasadës gjysmestrukturale në objektet e Muzeut. | m ² | 1 | 2.00 | 0.80 | W |
| 6 | Furnizimi me baze epokside 2 K SikaFloor 156 dhe poliuretani 2 k Sika Floor 359 ose ngjajshem dhe shtruarja e dyshemes se platos se Lapidarit. Nuansen e perzgjedh investitori | m ² | 1 | 25.00 | 10.00 | W |
| 7 | Furnizimi me material dhe riparimi i pllakave të qeramikes, të klasit të parë, të tipit të njejtë me ato egzistuese, në pozicion të përfshihet demolimi i pllakave, pastrimi i sipërfaqës, izolimi dhe gjitësi i nevojshëm dhe vendosja e pllakave sipas normave dhe standrateve në fuqi. | m ² | 1 | 20.00 | 8.00 | W |
| II | Gjithsejt punet e Objektivit (Muzeut) | | | 54.10 | 21.64 | W |

| B | OBORRI | | | | Çmimi i peshuar = 25 % |
|----|--|----------------|-----|-------|------------------------------|
| 1 | Pastrimi dhe rregullimi i tërë sipërfaqes së kompleksit nga barerat, zhkurret dhe krasitja e drunjeve ekzistuese të nevojshëm, materialet largohen në deponi e përcaktuar. | m ² | 1 | 12.00 | 3.00 |
| 2 | Mirëmbajtja dhe pastrimi i granitit në hapësirat e kompleksit (Varrezat, lapidari, amfiteater, shkallë dhe hapësira të tjera). Në pozicion të përfshihet pastrimi me preparate kimike adekuate dhe paisje tjera speciale për pastrim (sipas nevojës) | m ² | 1 | 4.00 | 1.00 |
| 3 | Furnizimi me plehra artificiale dhe plehërimi në kohën e pranverës dhe vjeshtës në hapësirat gjelbruese. | m ² | 1 | 4.00 | 1.00 |
| 4 | Furnizimi me dhe humusor, rregullimi ambientit dhe mbjellje e luleve dekorative | m ² | 1 | 4.00 | 1.00 |
| 5 | Furnizimi me dhe humusor dhe mbjellja e barit të parkut në hapësirat e caktuara për gjelbrim. | m ² | 1 | 2.00 | 0.50 |
| 6 | Furnizimi dhe mbjellja e drunjeve dekorative: bush, pishë, bredh, selvi, shelg, plep, bliri etj me lartësi deri në h= 3.0 m. | copë | 1 | 28.00 | 7.00 |
| 7 | Vendosja e vazove të betonit rreth shkallës-disnivelit të parë e të dytë me dimensione: 100x40x40 cm, ose të ngjashme. | copë | 1 | 32.00 | 8.00 |
| 8 | Furnizimi dhe rregullimi fontanes Ø 2.0-3.0 m, sigurimi pompes, ujesjellesit dhe kanalizimit për derdhje dhe pastrim të saj. | copë | 1.0 | 75.00 | 18.75 |
| 9 | Gryerja, pastrimi dhe sanimi i konstruktit nga betoni duke përfshirë në kosto edhe montimin e skeleve | m ² | 1 | 2.00 | 0.50 |
| 10 | Pastrimi dhe polirimi i granitit, mbishkrimeve dhe fotografive | m ² | 1 | 2.00 | 0.50 |
| 11 | Heqja e pllakave të demtuara të mermirit, granitit dhe shtresës nivelizuese ekzistuese të degraduara, bartja në deponi të qytetit | m ² | 1 | 2.00 | 0.50 |
| 12 | Heqja e kalldermi në vendet e demtuara, transporti i materialit në deponi | m ² | 1 | 2.00 | 0.50 |
| 13 | Heqja e kubezave të demtuara, transporti i materialit në deponi | m ² | 1 | 2.00 | 0.50 |
| 14 | Heqja e ansoreve të demtuara, transporti i materialit të demtuar në deponi | m | 1 | 3.00 | 0.75 |
| 15 | Heqja e pllakave të demtuara të terasës dhe shtresës nivelizuese të degraduara dhe bartja e materialit në deponi. | m ² | 1 | 2.00 | 0.50 |
| 16 | Furnizimi me material dhe rregullimi i kalldremi me trashësi t=10-15 cm. Në çmim të përfshihet stabilizimi i terrenit, shtresa nga zhavori, dhe vendosja e kalldermi të ri. | m ² | 1 | 9.00 | 2.25 |

| | | | | | |
|----|--|----------------|---|-------|-------|
| 17 | Furnizimi dhe montimi i kubzave te betonit me trashesi t=8.0 cm duke perfshi germimin, ngjeshjen, ne cmim te parashihet edhe vendosja e reres t=5.0 cm dhe mbushaj e fugave. Dizajni perzgjidhet nga investitori. | m ² | 1 | 11.00 | 2.75 |
| 18 | Furnizimi dhe montimi i kubzave te betonit me trashesi t=6.0 cm duke perfshi germimin, ngjeshjen, ne cmim te parashihet edhe vendosja e reres t=5.0 cm dhe mbushaj e fugave. Dizajni perzgjidhet nga investitori. | m ² | 1 | 10.00 | 2.50 |
| 19 | Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni 100x20x8 me te gjitha punet percjellese. | m | 1 | 4.00 | 1.00 |
| 20 | Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni 100x20x10 me te gjitha punet percjellese. | m | 1 | 5.00 | 1.25 |
| 21 | Furnizimi me material dhe punimi i shtreses nivelizuese (estrih) me trashesi mesatare ne 8 cm me trjet metali Ø 8 mm | m ² | 1 | 7.00 | 1.75 |
| 22 | Furnizimi me material dhe punimi i shtreses nivelizuese (estrih) me trashesi mesatare ne 6 cm. | m ² | 1 | 6.50 | 1.63 |
| 23 | Furnizimi me material dhe montimi i pllakave Teraco me trashesi: t=2.5-3.0 cm ne dysHEME, amfiteater, shkallë etj, lloji i materialit duhet te jete i ngjashem me ate egzistuese të llogaritet nëbaza me beton, llogaria në m ² . | m ² | 1 | 11.00 | 2.75 |
| 24 | Heqja e pllakave te gurit te demtuara, furnizimi me pilaka guri dhe vendosja e tyre ne pjesen e lapidarit, oborrit, amfiteatrit dhe hapsirave tjera me trashesi t=3.0-4.0 cm, në cmim te llogaritet edhe nëbaza betonit (5-8) dhe mbushja e fugave, lloji i materialit duhet të jete i ngjashem me atë egzistues. | m ² | 1 | 13.00 | 3.25 |
| 25 | Sanimi fugave te demtuara mes curve ne Lapidar | m ² | 1 | 14.00 | 3.50 |
| 26 | Furnizimi me material, renovimi, rregullimi dhe stabilizimi i varrezave. Në cmim të përfshihen të gjitha punët për rregullimin dhe stabilizimin e varrezave si: demolimi nga graniti, gërmimi, heqja e kubzave, zhavorit dhe shtresave të tjera perreth varrit, rivendosja e kubzave dhe shtresave tjera adekuate (në rast dëmtimit të vendosen të reja), stabilizimi me beton apo me ndonjë material tjetër adekuat. Në cmim të përfshihen të gjitha punët ndërtimore për stabilimin dhe rregullimin e varrit (sipas kërkesës së investitorit, ose gjendjes egzistuese). | copë | 1 | 55 | 13.75 |

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

u

| | | | | | | |
|----|--|----------------|---|-----|-------|---|
| 27 | Furnizimi dhe montimi i granitit te varrezave me te gjitha punet percjellese si dhe mbishkrimet e identifikimeve, me dimensione te varrezave: 220x100x35. Muret e varrit dhe pllaka e sipërme punohen me granit ose mermer, floji i materialit duhet te jete i ngjashem me ate egzistuese materialet e mermerit dhe granitit duhet te jen me trashsi 2cm dhe 3 cm. (forma dhe dizajni punohen ne baz te gjendjes egzistuese) | copë | 1 | 120 | 30.00 | u |
| 28 | Furnizimi me material dhe riparimi i pllakave të granitit t=1-2 cm të klasit të I-rë, të tipit të njejtë me atë ekzistues. Në pozicion të përfshihet demolimi i pllakave, pastrimi i sipërfaqes, izolimi dhe ngjitësi i nevojshem për punimin e granitit në ambient të jashtëm sipas normave dhe standardeve ne fuqi (forma dhe dizajni punohen ne baz te gjendjes egzistuese). | m ² | 1 | 14 | 3.50 | u |
| 29 | Furnizimi me material dhe riparimi i pllakave të granitit t=3-5 cm të klasit të I-rë, të tipit të njejtë me atë ekzistues. Në pozicion të përfshihet demolimi i pllakave, pastrimi i sipërfaqes, izolimi dhe ngjitësi i nevojshem për punimin e granitit në ambient të jashtëm sipas normave dhe standardeve ne fuqi (forma dhe dizajni punohen ne baz te gjendjes egzistuese). | m ² | 1 | 14 | 3.50 | u |
| 30 | Furnizimi me material dhe riparimi i pllakave të mermerit t=1-2 cm të klasit të I-rë, të tipit të njejtë me atë ekzistues. Në pozicion të përfshihet demolimi i pllakave, pastrimi i sipërfaqes, izolimi dhe ngjitësi i nevojshem për punimin e granitit në ambient të jashtëm sipas normave dhe standardeve ne fuqi (forma dhe dizajni punohen ne baz te gjendjes egzistuese). | m ² | 1 | 4 | 1.00 | u |
| 31 | Furnizimi me material dhe riparimi i pllakave të mermerit t=3-5 cm të klasit të I-rë, të tipit të njejtë me atë ekzistues. Në pozicion të përfshihet demolimi i pllakave, pastrimi i sipërfaqes, izolimi dhe ngjitësi i nevojshem për punimin e granitit në ambient të jashtëm sipas normave dhe standardeve ne fuqi (forma dhe dizajni punohen ne baz te gjendjes egzistuese). | m ² | 1 | 4 | 1.00 | u |
| 32 | Furnizimi me pllaka te gurve gjersi 20 cm dhe sanimi pjeseve te platis se demtuar | m ² | 1 | 9 | 2.25 | u |

| | | | | | | |
|-----|---------------------------|---|--|--------|--------|---|
| III | Gjithsejt punet e Oborrit | u | | 486.50 | 121.63 | u |
|-----|---------------------------|---|--|--------|--------|---|

| | | | | | |
|---|----------|--|--|--|------------------------|
| C | RRETHOJA | | | | Çmimi i peshuar = 20 % |
|---|----------|--|--|--|------------------------|

| | | | | | |
|----|---|----------------|---|-------|-------|
| 1 | Furnizim me material, mirëmbajtja dhe ngjyrosja e rrethojës metalike (pastrimi nga korezioni, baza dhe ngjyra) dhe riparimi eventual i rrethojës, me lartësi deri në h=100 cm | m | 1 | 5.00 | 1.00 |
| 2 | Furnizim me material, mirëmbajtja dhe ngjyrosja e rrethojës metalike (pastrimi nga korezioni, baza dhe ngjyra) dhe riparimi eventual i rrethojës, me lartësi deri në h=150 cm | m | 1 | 6.00 | 1.20 |
| 3 | Furnizimi dhe vendosja e elementeve mbyllesë në profilet e rrethojave 20x20 mm | copë | 1 | 3.00 | 0.60 |
| 4 | Riparimi i derës hyrëse metalike, të gjitha profilet të lyhen me baze ngjyre antikondivë. Dera duhet të ketë edhe cilindër dhe çelës për funksionim normal | m ² | 1 | 15.00 | 3.00 |
| 5 | Riparimi i derës rreshqitese të hyrjes në varreza me profile metalike, mekanizmi për hapje-mbyllje dhe të gjitha punët përcjellse, dizajni dhe forma sipas gjendjes egzistuese | m ² | 1 | 15.00 | 3.00 |
| 6 | Demolimi i rrethojave egzistuese metalike të demtuara, dhe zëvendësimi me rrethoja të reja, dizajni forma dhe dimensionet duhet të jenë të ngjashme me ato egzistuese. Rrethoja duhet të punohet deri në finalizim. | m ² | 1 | 10.00 | 2.00 |
| 7 | Furnizimi me profila dhe zinxhir, heqja e atyre të demtuar, ngjyrosja me ngjyre antikorozive h = 1m dhe zëvendësimi me rrethoja të reja | m | 1 | 11.00 | 2.20 |
| IV | Gjithsejt punët e Rrethojës | | | 65.00 | 13.00 |

| D | ELEKTRIKA | | | | Çmimi i peshuar = 15 % |
|---|--|----------|---|--------|------------------------|
| 1 | Mirëmbajtja e sistemit elektrik. Në çmim përfshihet mirëmbajtja, furnizimi, montimi dhe funksionalizimi i sistemit (apo pjesëve të sistemit) elektrik (sipas nevojës) - testimi dhe leshuarja në punë. | paushall | 1 | 45.00 | 6.75 |
| 2 | Sanimi dhe rregullimi i shtyllave elektrike të demtuara, ngjyrosja e tyre dhe vendosja e kokave dhe poqave ndriçuese që janë demtuar, me lartësi deri në 3.50 m | copë | 1 | 14.00 | 2.10 |
| 3 | Furnizimi, montimi i trupave ndriçues se bashku me shtyllën metalike dhe elementet tjera përcjellse me lartësi deri në H=3.5 m, (forma përcjellset sipas kërkesës së investitorit) | copë | 1 | 150.00 | 22.50 |
| 4 | Furnizimi me trupa ndriçues h=30 cm dhe poqa LED | copë | 1 | 14.00 | 2.10 |
| 5 | Furnizimi me trupa ndriçues, LED, h = 50 cm dhe vendosja e tyre në hapsirat e Lapidarit | copë | 1 | 18.00 | 2.70 |



| | | | | | |
|----|--|------|---|--------|-------|
| 6 | Furnizimi me trupa ndriçues dhe poqa elektrik (trup metalik, mbeshjtjellesi i poqit nga qelqi bardhe, lartesia h = 70 cm) | copë | 1 | 14.00 | 2.10 |
| 7 | Rregullimi trupave ndriçuese të demtuara dhe vendosja e poqave për ndriçim | copë | 1 | 15.00 | 2.25 |
| 8 | Furnizimi dhe vendosja e poqave elektrik Led 35 W | copë | 1 | 9.00 | 1.35 |
| 9 | Furnizimi dhe vendosja e reflektorve Led në shtylla të ndriçimit publik | copë | 1 | 14.00 | 2.10 |
| 10 | Furnizimi dhe vendosja e trupave ndriçues solar (pasi që nuk ka qasje në rrjetin elektrik) | copë | 1 | 30.00 | 4.50 |
| 11 | Furnizimi me reflektora Led 34 kw | copë | 1 | 22.00 | 3.30 |
| V | Gjithsejt punët e Elektrikes | | | 345.00 | 51.75 |

REKAPITULIM I PËRGJITHSHEM

| | | |
|---|---------------------------------------|--------|
| A | Gjithsejt punët e aksesorit | 224.00 |
| A | Gjithsejt punët e Objektivit (Muzeut) | 54.10 |
| B | Gjithsejt punët e Oborrit | 486.50 |
| C | Gjithsejt punët e Rrethojës | 65.00 |
| D | Gjithsejt punët e Elektrikes | 345.00 |

TOTALI: 1174.60

| Përshkrimi | Kategoria | Çmimi total për njësi i pa peshuar me TVSH në € | Çmimi total i peshuar |
|---|---------------|---|-----------------------|
| 1 | A | 278.10 € | 111.24 |
| 2 | B | 486.50 € | 121.63 |
| 3 | C | 65.00 € | 13.00 |
| 4 | D | 345.00 € | 51.75 |
| | Totali | 1,174.60 € | 297.62 |
| Çmimi i përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlerë). Në bazë të nenit 52 të LPP-së | | | |

| | |
|---|--|
| | IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) |
| EMRI I OE: | LIMIT L&b sh.p.k. |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Limani ASHRI |
| NËNSHKRIMI: |  |
| DATA: | 13.10.2023 T.SH |
| VULA: |  |

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-23-10114-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **GOE . Limit L&B SH.P.K.; REHA EPOXID SH.P.K., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN, Kosovë**

E-mail: **info@limitlb.com**

Personi kontaktues: **Liman Asllani**

Telefoni: **044502505**

Faxi: **029242213**

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **. Limit L & B SH.P.K.**

Numri fiskal: **810593617**

Vend-Selia: **Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **" REHA EPOXID " SH.P.K.**

Numri fiskal: **810147084**

Vend-Selia: **Potaqan i ulet, 21010, RAHOVEC, Kosovë**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-23-10114-5-2-1

Titulli i kontratës: Mirëmbajtja e komplekseve memoriale ne komunën e Prizrenit

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Mirëmbajtja e komplekseve memoriale ne komunën e Prizrenit

3. Çmimi total i tenderit është:

297.62 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

Deklaratë e garantuesit

GARANCI KONTRATE
POLICA NR. 070040340007712

Për: KOMUNA E PRIZRENIT
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: LIMIT L & B SHPK
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: MIREMBAJTJA E KOMPLEKSEVE MEMORIALE NE KOMUNEN E PRIZRENIT.

Numri i Prokurimit: 622-23-10114-5-2-1/622-23-137-5-2-1

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues.

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitoi sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit

DHE NGASE jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtënëshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej 20,000.00 € Njezet mijë Euro zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim :

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar, dhe si rezultat i sajë kanë mbet pa u paguar shumë punëtor, nënkontraktor dhe / ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 20,000.00 € siç është thënë më lart, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa ma shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me datën 27.3.2026



Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit financiar

Adresa:Rr. Qamil Hoxha, nr.51, Prishtinë

Data: 28.2.2024